



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:186253

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05433623

**P.nr.74/2023**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË** – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Xhemajl JUSUFI, me zyraren ligjore Doruntina BEKA, në lëndën penale ndaj të pandehurit A.... B...., me këtë ka kryer veprën penale Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1426/21 (2021:0054178) të datës 07.02.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 05.03.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit A.... B...., mbrojtësit të pandehurit, avokat Dijar Dinaj, me datë 05.03.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me datë 11.03.2024 e përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

A.... B...., nga i ati H...., e ëma M...., e vajzërisë H...., i lindur me datë 07.03.1997, në Mitrovicë, ku edhe jeton në Rr. “Xh.... D....”, me numër personal ....., ka të kryer shkollën e mesme, punon në kompaninë “J....” si menaxher, i martuar, baba i një fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse:

Me datë 11.08.2021, rreth orës 22:00 në Mitrovicë, i pandehuri e vë në lajthim organin kompetent duke përdorur dokumentin e rremë si te vërtetë ashtu që i njëjti lejen e rrejtshme te vozitjes me numër .... ne emër te tij, te lëshuar nga Ministria e Punëve te Brendshme, ia kishte prezantuar zyrtareve policor edhe pse ne ketë Ministri e kishte paraqitur se të njëjtin e kishte humbur me datën 28.07.2015, për te cilën ekziston edhe vërtetimi.

**Me këtë ka kryer veprën penale Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38 39, 40, 42,44, 69,70, e lidhur me nenin 395 të KPRK-së, dhe nenit 242, 364,450 dhe 452 të KPP-së, e:

## G J Y K O N

- I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II. Në kuptim të nenit 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muaj, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 400.00 (*me fjalë: katërqind*) euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur për çdo 20 euro gjobë të papaguar, me një (1) ditë burgim.
- III. Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 euro, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. URDHËROHET konfiskimi i lejes së vozitjes me numër.....
- V. Palë të dëmtuar në aktakuzë, nuk kishte të propozuar.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1426/21 të datës 07.02.2023 kundër të pandehurit A.... B.... me këtë ka kryer veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjykata për këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 05.03.2024, në të cilën kanë qenë të pranishëm prokurori i shtetit Ajtene Zoni, i pandehuri A.... B..... si dhe mbrojtësi i të pandehurit, avokat Dijar Dinaj.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, i pandehuri ka deklaruar se e ndjenë veten fajtor për veprën penale, se e kupton natyrën dhe pasojat juridike të pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e bënë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benefitet e pranimit të fajësisë, i vjen keq për rastin që ka ndodhur, ka qenë hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i njëjti ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se: konsideroj se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion dhe pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat lëndës, ndërsa lidhur

me sanksionin penal ka deklaruar që gjykata të pandehurin ta shpallë fajtor dhe me rastin caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana lehtësuese të merr pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa si rrethana rënduese të merr parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Mbrojtësi i të pandehurit Ardian Brahimi, avokat Dijar Dinaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar: se i propozon gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, pranim i cili është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimit të mjaftueshëm me të si mbrojtës, ndërsa lidhur me sanksionin penal ka deklaruar që gjykata të ketë parasysh rrethanat lehtësuese të cilat janë: pranimi i fajësisë, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, sjellja korrekte e të pandehurit, se i pandehuri është familjar, andaj për këto arsye i ka propozuar gjykatës që ndaj të pandehurit të shqiptoj një dënim më të butë..

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 242 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykatë si: shkresat sipas kallëzimit penal me numër të rastit 2021-BC-801, të datës 24.08.2021, raporti i zyrtarit hetues i datës 19.08.2021, raporti mbi verifikimin e dokumenteve të humbura i datës 28.07.2015, deklarata mbi humbjen e dokumentit e datës 28.07.2015, procesverbal mbi marrjen në pyetje të të pandehurit të datës 19.08.2021, fletëparaqitje për kundërvajtje e datës 30.06.2021, e kaluara kriminale si dhe shkresat tjera të lëndës. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimin të fajësisë, vërtetohet përtej çdo dyshimi se i akuzuari, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, dhe se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, duke i 'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimin të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga të pandehurit.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se me këtë ka kryer veprën penale: Legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 395 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vite.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë shkallën e përgjegjësisë penale, përkatësisht dashjen e lartë të kryesit në kryerjen e veprës penale, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sjellja e tij korrekte në gjykatë si dhe duke marrë parasysh keqardhjen e shprehur nga i pandehuri në seancë gjyqësore, rrethanat personale për faktin se i njëjti është person familjar.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë ndaj të pandehurit, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, Gjkata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu, ky dënim do të shërbejë si masë preventive që në të ardhmen të pandehurit të përmbahen nga çfarëdo veprimi që është i dëmshëm për shoqërinë në përgjithësi.

Gjkata ka vendosur si në pikën 3 të dispozitivit të këtij të Aktgjykimi dhe ka urdhëruar konfiskimin e sendit, respektivisht lejen e vozitjes me numër 30618869, duke u bazuar në nenin 269 par.1 dhe nenin 270 par.1 e lidhur me nenin 19 par.1 nën par.1.36 dhe 1.38 pika 1.38.1 të KPP-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449, 450 dhe 452 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor, ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.08\L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Palë të dëmtuar sipas aktakuzës, nuk kishte.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 242, 364 dhe 452 të KPP-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr.74/23, datë 11.03.2024**

Procesmbajtësja  
Doruntina BEKA

Gjyqtari  
Xhemajl JUSUFI

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të Aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.